



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AKADEMIA E SHKENCAVE
KRYESIA

Nr. 113 / 2 prot.

Tiranë, më 06.02 2024

V E N D I M

Nr. 17, datë 06.02 2024

“Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin e Kryesisë së Akademisë së Shkencave nr. 4, datë 10.1.2024 Për strukturën e organikën dhe emërimin e punonjësve kërkimorë-shkencorë, ndihmës tekniko-shkencorë dhe të administratës ndihmës të institutive të albanologjisë”

Në mbështetje të nenit 12 dhe 19 të ligjit nr. 53/2019 “Për Akademinë e Shkencave në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, të nenit 31, pika 7 të Statutit të Akademisë së Shkencave, i ndryshuar, referuar shkresave të drejtorit të qendrës së Studimit të Arteve me nr. 113 prot dhe nr. 113/1 prot., datë 31.1.2024,

Kryesia e Akademisë së Shkencave, në mbledhjen e saj të datës . .2024,

V E N D O S I:

1. Qendra e Studimit të Arteve përbëhet nga dy sektorë: Sektori i studimeve me 6 (gjashtë) punonjës dhe Sektori i shërbimeve me 3 (tre) punonjës.
2. Në lidhjen nr. 1 *Struktura dhe organika e njërive të kërkim-studimit në albanologji, Qendra e Studimit të Arteve* ndryshon sipas lidhjes nr. 1 të këtij vendimi.
3. Dr. Anxhela Hoxha Çikopano, caktohet drejtuese e sektorit të Studimeve pranë Qendrës së Studimit të Arteve.

4. Në lidhjen nr. 2 *Lista emërore e punonjësve kërkimorë-shkencorë*, pika V, Qendra e Studimit të Arteve riorganizohet sipas lidhjes nr. 2 bashkëngjitur.
5. Në lidhjen nr. 3 *Struktura, organika, lista emërore dhe niveli i pagave i punonjësve ndihmës tekniko-shkencorë*, pika 5 Qendra e Studimit të Arteve, riorganizohet sipas lidhjes nr. 3 bashkëngjitur.
6. Për ndjekjen dhe zbatimin e këtij vendimi ngarkohen: kryesia, kancelari, juristi.
7. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Akademik Skënder GJINUSHI

KRYETAR

